



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Datë: 03.07.2025
Numër Protokolli: 4743/2025

A.nr.826/2025

Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi-Bajraktari-anëtare, me Kaltrina Avdullahi Prenaj, në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.826/2025, të datës 05.05.2025, të parashtruar nga ankuesi, D.Xh, kundër organit të punësimit: Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në çështjen juridike “*Kompensim material*”, duke vepruar sipas nenit 6, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenit 16, paragrafi 3 dhe nenit 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të datës 03.07.2025, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa A.nr.826/2025, e datës 05.05.2025, e parashtruar nga ankuesi, D.Xh.

A r s y e t i m

Ankuesi, D.Xh, (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi), më datë 05.05.2025, përmes postës elektronike ankesa.kpmshck@rks-gov.net ka parashtruar ankesë me numër protokolli 2967/2025, në Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për shkak të mos rregullimit të Aktit të emërimit nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal.

Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, ndërsa, me datë 26.06.2025, ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi se ankesa e ankuesit është e palejuar, *sepse*:

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se ankuesi ka qenë i punësuar në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, dhe se i njëjti sipas Aktit të emërimit me Nr.95 dhe ref.1/207, të datës 29.10.2012, ka ushtruar pozitën e punës *Zyrtar Ligjor*, në Divizionin për Zbatimin e Legjislacionit, ndërsa sipas Vendimit me numër protokolli Nr.112-533/5, të datës 08.04.2024, është

caktuar si ushtrues detyre i Zyrtarit të Lartë të Monitorimit në Divizionin për Monitorim të Komunave në Departamentin Ligjor dhe Monitorim të Komunave nga data 12.04.2024 deri më 11.10.2024, me Vendimin me Nr.MAPL.707/2024, të datës 26.03.2025 të Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, ankuesi është transferuar në pozitën zyrtar i Lartë për shqyrtimin e Ligjshmërisë së Akteve të Komunës, në Divizionin për Shqyrtimin e Ligjshmërisë së Akteve të Komunale, sipas përgjigjes në ankesë të datës 25.06.2025 (*të dorëzuar nga organi i punësimit: MAPL*), i njëjti nuk është në marrëdhënie pune në MAPL, por në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Ankuesi ka parashtruar ankesën në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për shkak të mos rregullimit të akt emërimit dhe mos pagesës komform legjislacionit në fuqi si Zyrtar Profesional 1. Kërkon nga Këshilli që të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të detyroj Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal që të bëj pagesën, nga hyrja në fuqi e Rregullores (ZKM), Nr.17/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës, gjegjësisht për periudhën janar, mars, shtator, tetor, nëntor, dhjetor, 2024 si Zyrtar me klasë të pozitës Profesional 1, ashtu siç, ka vendosur DMZP-ja.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave lidhur me pranueshmerinë e ankesës iu referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenit 27 paragrafi 3 ku përcaktohet se: *3. Nëpunësi civil ka të drejtë të paraqes ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto që burojnë nga marrëdhënia e punës në shërbimin civil*, si dhe dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht neni 124 ku përcaktohet se: *1. Pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e saj juridike cenohen nga ky veprim apo mosveprim*, dhe si rrjedhojë referuar dispozitave përkatëse ligjore konstatoi se nëpunësi civil ka të drejtë të paraqes ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme të cilat burojnë nga marrëdhënia e punës, mirëpo kur kemi të bëjmë me realizimin e të drejtave sikurse në rrethanat e rastit konkret, nëpunësi civil fillimisht duhet t'i drejtohet organit të punësimit me kërkesë për realizimin e të drejtës se pretenduar dhe vetëm kundër aktit për refuzimin e kërkesës apo heshtjes se organit publikë në raport me kërkesën e parashtruar, mund të parashtroj ankesë sipas afateve të përcaktuara me dispozitat e nenit 127 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kolegji i Këshillit, bazuar në kudrin përkatës ligjor si dhe nga shqyrtimi dhe analizimi i shkresave të lëndës të percjella nga palët në procedurë ka konstatuar se ankuesi lidhur me objektin e ankesës gjegjësisht lidhur me të drejtën e tij për rregullimin e akt emërimit nuk i është drejtuar paraprakisht me kërkesë organit të punësimit, gjegjësisht Njesisë për Burime Njerëzore në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, veprim ky i domosdoshëm për inicimin e procedurës administrative sipas dispozitave të ligjit përkatës për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Si rrjedhojë, në mungesë të kërkesës se parashtruar të organi i punësimit për realizimin e të drejtës se pretenduar, nga ankuesi, në rastin konkret nuk kemi objekt trajtimi ngase mungon veprimi apo mosveprim nga organi i punësimit në raport me të drejtën e pretenduar në ankesë, për çka ankuesi mund të kontestonte ligjshmërinë e veprimit të organit të punësimit, apo mosveprimin e saj.

Kështu që, për sa me sipër dhe duke marr parasysh faktin se ankuesi nuk ka parashtruar kërkesë të organi përkatës i punësimit për realizimin e kërkesës së saj, Kolegji konstaton se në rrethanat e rastit konkret nuk janë plotësuar kushtet ligjore për pranueshmerinë e ankesës në kuptim të nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe se duke u mbështetur në dispozitat e nenit 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-

048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi që të hedhë poshtë ankesën si të palejueshme, ashtu sikurse në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë Juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit. Pala e pakënaqur, e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.826/2025

Kaltrina Avdullahi Prenaj

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj Demi

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- *Ankuesit, D.Xh;*
- *Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal; dhe*
- *Arkivit të KPMSHCK-së.*